



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1057 Prot.

Tiranë, më datë 18.11.2020

VENDIM

Nr. 396, datë 18.11.2020

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 18.11.2020,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Rikonstruksion/rindërtim banese ekzistuese 1 kat”, Zona A, Durrës me aplikues Z.Andi Rizja, investitor Fiona dhe Florian Rizja, hartuar nga subjekti “Mema” sh.p.k. dhe Ing. Rest. Genc Samimi;
2. Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin e “Rikonstruksion/rindërtim banese ekzistuese 1 kat” si dhe Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt;
3. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 72, pika 1 dhe 2;
4. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
6. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Elva MARGARITI

SEKRETAR

Arta DOLLANI

Arta
Dollani

Digitally signed by Arta Dollani
DN: cn=Arta Dollani, o=Ministria e Kulturës,
ou=Direktor i Përgjithshëm,
c=Albania
Date: 2020.11.19 16:32:32
+01'00'

Elva
Margariti

Digitally signed
by Elva Margariti
Date: 2020.11.19
17:33:00 +01'00'